

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 572 Prot.

Tiranë, më 03.062016

VENDIM Nr. 36, datë 20.05.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"(i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, në kuadër të Shkollës Doktorale Arkeologjike "Për bashkëpunimin e Institutit të Arkeologjisë dhe Universitetit të Barit, Itali "*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtues Prof. Luan Përzhita (IA) dhe Prof. Roberta Belli (Universiteti i Barit, Itali),

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, në kuadër të Shkollës Doktorale Arkeologjike "Për bashkëpunimin e Institutit të Arkeologjisë dhe Universitetit të Barit, Itali "*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtues Prof. Luan Përzhita (IA) dhe Prof. Roberta Belli (Universiteti i Barit, Itali), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Plotësimi me dokumentacionin tekniko-shkencor i fortifikimit helenistik të Bylisit dhe qyteti antik të Klosit.
2. Periudha kohore e realizimit do të jetë do të jetë 6-14 Maj; 11-30 Shtator 2016.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO